



Funded by
the European Union



MODELI KOLEGIAL I SIGURIMIT TË CILËSISË NË KOSOVË

UDHËZUES PËR VETË- VLERËSIMIN E SHKOLLËS

Projekti "Përkrahje për arsimin fillor dhe të mesëm të lartë"

Periudha e vetëvlerësimit

Vetë-vlerësimi duhet të kryhet gjatë një periudhe 6-8 javore.

Procesi i vetëvlerësimit duhet të jetë sa më efikas që është e mundur.

Shkollat duhet t'i formojnë ekipet për ta vlerësuar secilin prej pesë standardeve/fushave të cilësisë.

1. Menaxhimi dhe Qeverisja
2. Kultura dhe Mjedi Shkollor
3. Mësimdhënia, mësim-nxënia dhe vlerësimi
4. Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve me bazë në shkollë
5. Performanca e nxënësve

Ekipet duhet të kërkojnë dëshmi që shkolla i përmbush këto standarde dhe treguesit brenda tyre.

Ekipi, po ashtu, duhet të familjarizohet me dokumentet e mëposhtme:

1. Matrica e vëzhgimit të orës së mësimi
2. Udhëzuesi praktik për praktikën pedagogjike efektive
3. Udhëzuesi praktik për vëzhgimin efektiv të orës mësimore

Trekëndëshimi i dëshmimeve

Dëshmitë duhet të trekëndëzohen përpara se të shkruhet vetëvlerësimi. Një opinion nuk është i vlefshëm nëse bazohet vetëm në një burim të dëshmimeve. Ai duhet të bazohet në të paktën dy ose tri dëshmi.

Burimet e dëshmimeve përfshijnë:

- Dokumentacioni i planifikimit.
- Analiza e rezultateve të anketës
- Dëshmitë nga vëzhgimi i orëve mësimore.
- Dëshmi nga librat e nxënësve, portfoliot e vlerësimit, etj.
- Procesverbalet nga mbledhjet e këshillit të nxënësve ose mbledhjet e këshillit të shkollës.
- Dëshmi nga punëtoritë për zhvillimin profesional të mësimdhënësve me bazë në shkollë.
- Dëshmi fizike siç janë prezantimet e punimeve në klasë dhe burimet.

Shembuj të trekëndëshimit të dëshmimeve

Shembulli 1

Ekipi i vetëvlerësimit nuk duhet të arrijë në një përfundim duke u bazuar vetëm në shikimin e dokumentacionit të planifikimit. Vlerësuesi i trekëndëzon dëshmitë nga dokumentacioni i planifikimit duke i krahasuar me dëshmitë nga vëzhgimi i orëve të mësimit dhe bisedat me nxënësit lidhur me mësimdhënies dhe të nxënit.

Shembulli 2

Ekipi i vetëvlerësimit nuk duhet ta vlerësojë cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënit duke u bazuar në dëshmitë nga një orë e mësimit. Ekipi i vetëvlerësimit duhet të vëzhgojë sa më shumë orë mësimi që është e mundur. Vlerësuesi duhet, po ashtu, të përdorë dëshmi nga bisedat me nxënësit dhe analiza e punës së tyre përpara se të shkruajë raportin e vetëvlerësimit.

Vëzhgimi i orëve të mësimit

Është thelbësore që të vëzhgohen (jo-formalisht) sa më shumë orë mësimore që është e mundur për të siguruar dëshmi të forta.

Nuk është e nevojshme që **vetëm** ta vëzhgojnë **tërë** orën mësimore, sepse ekipi i vetëvlerësimit **nuk** do të kenë kohë të mjaftueshme për ta vëzhguar çdo mësimdhënës për një periudhë prej 4 deri në 6 javë.

Është më efektive nëse ekipi përdor shumëllojshmëri të strategjive të vëzhgimit të orës mësimore;

1. Vëzhgoni një numër të vogël të përzgjedhur të orëve të plota mësimore 45-minutëshe
2. Vëzhgoni një numër më të madh të orëve mësimore për 25 minuta
3. Kryeni një varg vëzhgimesh të shkurtra 10-minutëshe të orëve mësimore për një periudhë prej 1 deri në 2 orë.

Përdorimi i një sërë teknikash të vëzhgimit do t'i ofrojë ekipit një pasqyrë më të plotë të mësimdhënies dhe mësim-nxënies në shkollë.

Ekipi duhet të synojë ta vëzhgojë çdo mësimdhënës në shkollë (edhe nëse është vetëm për 10 minuta). Nëse ka kohë ose nëse ekipi është mjaft i madh, mësimdhënësit duhet të vëzhgohen disa herë.

Rubrika e vëzhgimit të orës mësimore përdor nivele për t'i ndihmuar vëzhguesit të japin informata kthyesë konstruktive. Mirëpo, ajo nuk duhet të përdoret për t'i vlerësuar mësimdhënësit pasi që vlerësimi është subjektiv dhe një orë mësimi nuk mund ta përfaqësojë në mënyrë të drejtë një fazë të mësimnxënies.

Roli i vlerësuesve **nuk është që t'i vlerësojë dhe gjykojë** mësimdhënësit. Roli kryesor i tyre është mbledhja e dëshmive që mbështesin dokumentin e vetëvlerësimit dhe çojnë në rekomandime konstruktive që do ta përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënit në shkollë.

Anketat

Shkolla duhet t'u dërgojë pyetësorë prindërve, stafit dhe nxënësve për të mbledhur dëshmi që e informojnë vetëvlerësimin e shkollës.

Në rrethana ideale, pyetësorët do të duhej të dërgoheshin në format online në mënyrë që të analizohen rezultatet në mënyrë më efikase.

Hartimi i vetëvlerësimit të shkollës.

Raporti mund të shkruhet nga një person pas konsultimit me ekipin e sigurimit të cilësisë. Ose, kjo përgjegjësi mund të ndahet. Megjithatë, është me rëndësi që stili i raportimit të jetë konsistent dhe që të gjitha opinionet të mbështeten me dëshmi.

Një ose dy paragrafë të shkurtër janë të mjaftueshëm për secilin tregues. Është me rëndësi që ekipi i vetëvlerësimit ta shkruajë një vlerësim të sinqertë. Procesi është një proces mbështetës i udhëhequr nga kolegët, i krijuar për të dhënë rekomandime mbështetëse.

Nëse ekipi i vetëvlerësimit nuk gjen dëshmi se shkolla i plotëson kërkesat e standardit, atëherë kjo duhet të shkruhet në raportin e vetëvlerësimit.

Shembuj të komenteve të vetëvlerësimit

Komentet me dëshmi

Bisedat me stafin, nxënësit dhe prindërit dhe dëshmitë nga pyetëtorët tregojnë se këshilli i shkollës kontribuon në shumë vendime të shkollës. Të gjithë anëtarët e komunitetit të shkollës marrin rregullisht pyetësorë të cilët analizohen nga drejtoria e shkollës. Mirëpo, meqenëse të gjithë pyetëtorët janë në format të letrës, kërkohet kohë për t'i analizuar.

Këshilli i nxënësve e ka filluar një fushatë për ta mirëmbajtur pastërtinë e shkollës, e që mbështetet nga drejtoria e shkollës. Megjithatë, nga bisedat me stafin dhe nxënësit doli në pah se stafi nuk ishte në dijeni të pikëpamjeve të nxënësve lidhur me cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënësve në shkollë.

Komentet me dëshmi

Dëshmitë nga planifikimi i orës mësimore, bisedat me nxënësit dhe vëzhgimet e orëve mësimore tregojnë se mësimdhënësit përdorin një varg strategjish të bazuara në dëshmi në orët e mësimin. Ekipi i vetëvlerësimit i ka vëzhguar strategjitë e mësimdhënies së përgjegjshme, strategjitë e të nxënësve bashkëpunues, diferencimin e njësive mësimore sipas përmbajtjes.

Megjithatë, informatat kthyesë të nxënësve karakterizohen me përdorimin e notave (1,2,3,4,5) pa informata kthyesë cilësore. Ekipi i vetëvlerësimit ka parë pak dëshmi të përdorimit të rubrikave nga mësimdhënësit.

Krijoni një dosje elektronike dhe fizike të dëshmive për ekipin vizitues

Kur të përfundohet raporti i vetëvlerësimit, shkolla duhet t'ia dërgojë raportin e tyre DKA-së.

Nëse është e mundur, shkolla do të përfshijë edhe qasjen në dosjen elektronike me shembuj të dëshmive siç është dokumentacioni i planifikimit, fotot e punës së nxënësve, informatat kthyesë nga vëzhgimi i orëve mësimore, etj.

Kjo dosje duhet të ndahet me DKA-në në mënyrë që të mund të ndahet me ekipin komunal të sigurimit të cilësisë të shkollave.

Shkolla, po ashtu, duhet ta krijojë një dosje fizike të dëshmive për t'ia dhënë ekipit të sigurimit të cilësisë.

Dosja/dosjet duhet të përmbajnë llojet e mëposhtme të dëshmive:

1. Dokumentacioni i planifikimit.
2. Analiza e rezultateve të anketës
3. Dëshmitë nga vëzhgimi i orëve mësimore.
4. Dëshmi nga librat e nxënësve, portfoliot e vlerësimit, etj.
5. Procesverbalet nga mbledhjet e këshillit të nxënësve ose mbledhjet e këshillit të shkollës.
6. Dëshmi nga punëtoritë për zhvillimin profesional të mësimeve me bazë në shkollë.



Kosovo Legal
Services Company



IBE



EDUCATIONAL
RESEARCH
INSTITUTE

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Projektit KosEd dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.